



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:133569  
Datë: 20.11.2024  
Numri i dokumentit: 06479891

AC.nr.6158/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mevlide Kosumi Qarri, kryetare e kolegjit, Naime Ahmeti dhe Halide Reka, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike-kontestimore të paditësve T. X., Sh.B., T. M., H. G., V. D., të gjithë me vendbanim në Prishtinë, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit D.Z. avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimi i pagave mbi bazën e kualifikimit, duke vendosur në lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4727//2021, i datës 01.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.11.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4727//2021, i datës 01.08.2022, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.4727//2021, i datës 01.08.2022, ka vendosur si në vijim: I “Aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësve T. X., Sh. B., T.M., H. G., V. D., të gjithë me vendbanim në Prishtinë, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit D. Z. avokat në Prishtinë. II Detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë, që paditësve secilit veç e veç në emër të kompensimit të pagave mbi bazën e kualifikimit, t’ua paguaj shumat dhe atë: Paditëses T.X. nga Prishtina ti paguaj shumën e përgjithshme prej 2,831.75€ (dymijë e tetëqind e tridhjetë e një e shtatëdhjetë e pesë). Paditëses Sh. B. nga Prishtina ti paguaj shumën e përgjithshme prej 3,670.70€ (tremijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë euro). Paditëses T. M. nga Prishtina ti paguaj shumën e përgjithshme prej 3,670.70€ (tremijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë euro). Paditëses H. G. nga Prishtina ti paguaj shumën e përgjithshme prej 3,670.70€ (tremijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë euro). Paditëses V. D. nga Prishtina ti paguaj shumën e përgjithshme prej 3,670.70€ (tremijë e gjashtëqind e

*shtatëdhjetë e shtatëdhjetë euro). III Detyrohet e paditura që shumat e përcaktuara sikurse në pikën II të dispozitivit tua paguaj paditësve secilin veç e veç me kamat ligjore prej 8 % nga dita e parashtrimit të padisë( 25.06.2021) e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1,535.20 euro të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit “.*

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur e paditura përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën ta aprovojë si të bazuar, ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim, apo ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tersi si të pabazuar.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i paditësve ka kërkuar që Gjykata e Apelit ankesën e paraqitur nga e paditura ta refuzojë në tërësi si të pabazuar ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se të paditësit, përmes të autorizuarit, me datë 25.06.2021, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin diferencës së pagave mbi bazën e kualifikimit. Me parashtrësën e datës 22.06.2022 ka bërë precizimin e kërkesëpadiës në kuptim të lartësisë për secilin veç e veç. Në shqyrtimin kryesor si dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësve ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë së precizuar. Tutje ka shtuar se paditëset i posedojnë diplomat, për studimet të cilat i kanë përfunduar në fusha të caktuara, në kohëzgjatje prej 4.5 vite dhe 5 vite, të cilat janë të barasvlefshme me 300 ECTS, pikë këto të cilat përkojnë me numrin e pikëve për studimet e përfunduara master. Ka theksuar se bazën juridike të kërkesëpadiës e mbështesin në nenin 7 të Kontratës Sektoriale të Arsimit, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008 si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 11 i nxjerrë nga MASHT, i dt.21.09.2015, duke kërkuar me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi e deri në ekzekutim të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.4727//2021, i datës 01.08.2022 me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsytim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka ardhur në përfundim se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditëset secila veç e veç janë në marrëdhënie pune me të paditurën. Po ashtu nuk ishte kontestuese se paditëset posedojnë me diploma të përgatitjes bachelor si dhe me diploma master, si dhe licencë të mësimdhënësit, lëshuar nga Ministria e Arsimit

Shkencës dhe Teknologjisë. Po ashtu në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese lartësia e kërkesëpadisë. Por si çështje kontestuese deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ishte baza juridike e kërkesëpadisë dhe atë nëse paditëseve u takon kompensimi – diferenca e pa paguar mbi bazën e kualifikimit apo jo dhe nëse e paditura ka linjë të veçantë buxhetore për përmbushjen e obligimeve që dalin nga kontrata si dhe nëse paditësi ka shtetur të gjitha mjetet juridike për realizimin e kërkesës së tij. Nga leximi i kontratës së punës me nr. prot. 195 e dt 01.09.2005 gjykata ka vërtetuar se paditësja T. X. ka lidhur kontratë pune në afat të pacaktuar me të paditurën Komuna e Prishtinës, nga e cila vërtetohet se e njëjta është në marrëdhënie pune me SHME ... dhe mban titullin mësimdhënëse. Nga diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Kulturës Fizike rezulton se paditësja ka mbaruar fakultetin e Kulturës Fizike duke marrë kualifikimin Profesor i Kulturës Fizike. Nga Licenca e mësimdhënësit, nr.100016257 të lëshuar nga MASHT, rezulton se paditësja është licencuar me Licencë e Karrierës dhe nga Vërtetimi i lëshuar nga SH.m.e .... me dt.25.05.2021, vërtetohet se nga data 01.09.2005 e tutje është në marrëdhënie pune me SHME Gjin Gazuli. Kurse nga lista e pagave të realizuar për muajin Maj 2021, gjykata ka vërtetuar se e njëjta ka pagën bazë në shumën prej 495 euro, kurse për kualifikim është kompensuar në shumën 63.68 euro. Nga leximi i kontratës së punës me nr. prot. 1.. e dt 01.09.1985 gjykata ka vërtetuar se paditësja Sh. B. ka lidhur kontratë pune në afat të pacaktuar me të paditurën Komuna e Prishtinës, nga e cila vërtetohet se e njëjta është në marrëdhënie pune me SHME Gjin Gazuli dhe mban titullin Master i Elektroenergjetikes Industriale. Nga shtojca e diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike rezulton se paditësja ka mbaruar fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike duke marrë kualifikimin inxhinier i diplomuar i elektroteknikes. Kohëzgjatja e studimeve të ndjekura nga paditësja ka qenë 5 vite/ 10 semetra. Në pjesën tek shtojca e diplomës – tek informacionet shtese është përshkrimi: studimet themelore universitare sistemi i para- Bolonjës 5 vite/ 10 semetra ekuivalent me 300 ECTS Kredi- bazuar në kohëzgjatjen e studimeve sipas Udhëzimit Administrativ 20/2012. Nga Licenca e mësimdhënësit, nr.10..... të lëshuar nga MASHT, rezulton se paditësja është licencuar me Licencë e Karrierës kurse nga Vërtetimi i lëshuar nga Sh.m.e GJIN Gazuli në Prishtinë i dt.01.06.2021, vërtetohet se nga data 01.09.1985 e tutje është në marrëdhënie pune me SHME Gjin Gazuli. Kurse nga lista e pagave të realizuar për muajin Maj 2021, gjykata ka vërtetuar se e njëjta ka pagën bazë në shumën prej 495 euro, kurse për kualifikim është kompensuar në shumën 82.55 euro. Nga leximi i kontratës së punës me nr. prot. 1... e dt 05.09.2001 gjykata ka vërtetuar se paditësja T. M. ka lidhur kontratë pune në afat të pacaktuar me të paditurën Komuna e Prishtinës, nga e cila vërtetohet se e njëjta është në marrëdhënie pune me SHME Gjin Gazuli dhe mban titullin Master i Energjetikes. Nga diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Elektroteknikes rezulton se paditësja ka mbaruar fakultetin Elektroteknik, drejtimin e Energjetikes, duke marrë kualifikimin Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës, më datën 07.01.1991. Nga shtojca e diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike rezulton se paditësja ka mbaruar fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike duke marrë kualifikimin inxhinier i diplomuar i elektroteknikes. Kohëzgjatja e studimeve të ndjekura nga paditësja ka qenë 5 vite/ 10 semetra. Në pjesën tek shtojca e diplomës –tek informacionet shtese është përshkrimi: studimet themelore universitare sistemi i para- Bolonjës 5 vite/ 10 semetra ekuivalent me 300 ECTS Kredi- bazuar në kohëzgjatjen e studimeve sipas Udhëzimit Administrativ 20/2012. Nga Licenca e mësimdhënësit, nr.100016256 të lëshuar nga MASHT, rezulton se paditësja është licencuar me

Licencë e Karrierës dhe nga Vërtetimi i lëshuar nga SH.m.e Gjin Gazuli me dt.25.05.2021, vërtetohet se nga data 05.09.2001 e tutje është në marrëdhënie pune me SHME Gjin Gazuli. Kurse nga lista e pagave të realizuar për muajin Maj 2021, gjykata ka vërtetuar se e njëjta ka pagën bazë në shumën prej 495 euro, kurse për kualifikim është kompensuar në shumën 82.55 euro. Nga leximi i kontratës së punës me nr. prot. 1... e dt 09.12.2004 gjykata ka vërtetuar se paditësja H. G., ka lidhur kontratë pune në afat të pacaktuar me të paditurën Komuna e Prishtinës, nga e cila vërtetohet se e njëjta është në marrëdhënie pune me SHME Gjin Gazuli dhe mban titullin mësim dhënëse. Nga diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Elektroteknikes rezulton se paditësja ka mbaruar fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dega Kompjuterike me Telekomunikacion, duke marre kualifikimin Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës, më datën 14.07.2008. Nga shtojca e diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike rezulton se paditësja ka mbaruar fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike duke marre kualifikimin inxhinier i diplomuar i elektroteknikes. Kohëzgjatja e studimeve te ndjekura nga paditësja ka qenë 4.5 vite/ 9 semetra. Në pjesën tek shtojca e diplomës –tek informacionet shtese është përshkrimi: studimet themelore universitare sistemi i para- Bolonjës 4.5 vite/ 9 semestra ekuivalent me 300 ECTS Kredi- bazuar në kohëzgjatjen e studimeve sipas Udhëzimit Administrativ 11/2015. Nga Licenca e mësimdhënësit, nr.1.... te lëshuar nga MASHT, rezulton së paditësja është licencuar me Licencë e Karrierës dhe nga Vërtetimi i lëshuar nga SH.m.e Gjin Gazuli me dt.28.05.2021, vërtetohet se nga data 09.12.2004 e tutje është në marrëdhënie pune me SHME Gjin Gazuli. Kurse nga lista e pagave të realizuar për muajin Maj 2021, gjykata ka vërtetuar se e njëjta ka pagën bazë në shumën prej 495 euro, kurse për kualifikim është kompensuar në shumën 82.55 euro. Nga leximi i kontratës së punës me nr. prot. 2... e dt 11.10.2006 gjykata ka vërtetuar se paditësja V.D. ka lidhur kontratë pune në afat të pacaktuar me të paditurën Komuna e Prishtinës, nga e cila vërtetohet se e njëjta është në marrëdhënie pune me SHME Gjin Gazuli dhe mban titullin mësim dhënëse. Nga diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Elektroteknikes rezulton se paditësja ka mbaruar fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dega Kompjuterike me Telekomunikacion, duke marre kualifikimin Baçelor i Inxhinierisë Elektrike me gjithsej 180 pikë- ECTS. Nga diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike rezulton se paditësja ka mbaruar fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike – Departamenti Elektronik duke marre kualifikimin Master i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike, data 11/05/2016. Nga Licenca e mësimdhënësit, nr.1.... te lëshuar nga MASHT, rezulton së paditësja është licencuar me Licencë e Karrierës dhe nga Vërtetimi i lëshuar nga SH.m.e Gjin Gazuli me dt.28.05.2021, vërtetohet se nga data 11.10.2006 e tutje është në marrëdhënie pune me SHME Gjin Gazuli. Kurse nga lista e pagave të realizuar për muajin Maj 2021, gjykata ka vërtetuar se e njëjta ka pagën bazë në shumën prej 495 euro, kurse për kualifikim është kompensuar në shumën 82.55 euro.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë vendimin e ka mbështetur konform nenit 2 paragraf 1, pika 1.2, 7 paragraf 1, pika 1.1 . 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, nenit 33 paragraf 1, pika 1.1 të UA për Sistemimin e Licencimit dhe Zhvillimin e Mësimdhënësve në Karrierë, nenit 245 paragraf 1 të LMD-së, lidhur me nenin 329 paragraf 1 të LPK-së. Lidhur me kamatën e gjykuar ka vendosur konform nenit 382 paragraf 1 dhe 2 të LMD-

së, ndërsa për shpenzimet e procedurës kontestimore në bazë të nenit 452 paragraf 3 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Pretendimet e të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) sepse dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin si dhe i njëjti nuk mund të ekzaminohet nuk qëndrojnë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Me nënshkrimin e Kontratës Kolektive nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe përfaqësuesit të paditësit të sektorit të arsimit, Ministria ka marrë obligime në emër dhe llogari të të paditurës, ndërsa obligimi për kompensim bie mbi të paditurën pasi është punëdhënës i paditësve. Koordinimi ndërmjet nivelit lokal (Komunës) dhe nivelit qendror (Qeverisë-Ministrisë) nuk afekton në të drejtën e paditësve.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet e mësipërme ankimore, por vlerëson se të njëjtat nuk qëndrojnë dhe se nuk kanë peshë në vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton të provohet fakti se paditësit nga licencat e lëshuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të njëjtit janë licencuar për të punuar në sektorin e arsimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin, nr.01/33, i datës 29.08.2008 në pikën 1, ka vendosur që: *Nga 1 shtatori i vitit 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave në bazë të kriterëve të licencimit*, ndërsa pika 4, ka përcaktuar se: *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: 1) Me diplomë të shkollës normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2) Me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagë bazë prej 19% 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%, 4) Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës Diplomave të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina“, vërtetohet fakti se paditësit kanë diplomuar, nga kontratat e punës është vërtetuar se të njëjtit kanë lidhur kontratë me të paditurën Komuna e Prishtinës në afat të pacaktuar si mësimdhënës, dhe të njëjtit janë pajisur me licencën e mësimdhënësit të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Në rastin konkret, Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është vendosur kur paditësve i'u është aprovuar kërkesëpapia lidhur me kompensimin e diferencës në pagë në emër të licencimit, ani pse Gjykata e Shkallës së parë është thirrur se kjo e drejtë është përcaktuar me Kontratën Kolektive të Arsimit, kjo Gjykatë vlerëson se kjo e drejtë nuk derivon nga Kontrata Kolektive e Arsimit edhe pse është e përcaktuar me të. Ky përfundim i Gjykatës së Apelit, vie edhe nga Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës, G.J.A-Su.A, 214/2023, i datës 05.10.2023, ku është përcaktuar se për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33, i datës 29.08.2008.

Pra vendimi i Qeverisë së RKS, ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023 deri në periudhën kur edhe është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196 dhe ky vendim është dashur që të zbatohet që nga dita e nënshkrimit e deri në momentin kur ka qenë në fuqi, e që e paditura duke vepruar në kundërshtim me këtë vendim ia ka mohuar paditëses një të drejtë që i ka takuar.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimet e të paditurës se paditësit paguhet sipas kontratës së punës që është lidhur dhe se me konkurs nuk është përcaktuar se mësimdhënësit paguhet sipas licencimit, ky pretendim është tejet irrelevant, pasi që kemi një Vendim të vetë Qeverisë së Republikës së Kosovës që ka pasur karakter detyrues dhe si i tillë është dashur detyrimisht të zbatohet, pavarësisht asaj se çka është përcaktuar me kontratë sepse me kontratë përcaktohet fillimisht paga bazë, por asnjëherë nuk mund të jetë përcaktues i pagës, shtesave apo edhe kushteve të tjera të punonjësit që përcaktohen me Ligj apo vendime të organeve të Republikës së Kosovës.

Kjo Gjykatë pati parasysh edhe pretendimet se një kompensim i tillë nuk është paraparë me ligjin e punës dhe as me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës këto pretendime janë të pa bazuara për faktin se sipas kontratës të gjitha DKA e institucioneve të arsimit të lartë, e në rastin konkret edhe e paditura është e obliguar që ta zbatoj këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikoj buxhetin për këto raste.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palës ankuese, por që gjeti se nuk janë relevante, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
AC.nr.6158/2022 datë 18.11.2024

Kryetarja e kolegjit  
Mevlide Kosumi Qarri d.v.